



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR.7)

Mirëmbajtje me performance rruga: "**Lezhë (D/Grykë Manati)- Ura e Matit (e trenit), Ura e vjeter Milot -Ura e re Milot (E Trenit), Rrëshen (Ura e Fanit) - Ura e Matit (e vjetra), K/Milot -Ura e Matit (e Trenit) "**

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor “**Ura e Matit(e trenit)-Lezhe (deg.Gryke Manati) (10.7 km)**, është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Milotit me Lezhen. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren fushor, i cili nuk përfshihet në si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor “**Ura e re Milot (Trenit)-Ura e Vjeter Milot” 2.6 km** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër, prej vitesh dhe është pjesë e Projektit të Mirëmbajtjes nga ana e kesaj Drejtorie. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Milotit me Rubikun. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të rrafshet bregut te Lumit Mat, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje rutine.

Aksi rrugor “**Ura e Matit(e vjetra)-Rrëshen(Ura e Fanit)” 22.2km** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër, por që prej shume vitesh është pjesë e Projektit të Mirëmbajtjes së Drejtorise Rajonale Veriore Shkoder. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Lezhes dhe te Milotit me ate Rubikut,Rrëshenit,Fushe Arres,Puke dhe Kukës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren malor, i cili përfshihet si segment me mirëmbajtje dimërore. Ky segment shtrihet ne te gjithë gjatesine e tij brigjeve te lumit Mat dhe Fan.

Aksi rrugor **“K/Milot -Ura e Matit (e Trenit)” 1.1 km** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër, por që prej shume vitesh është pjesë e Mirëmbajtjes së Drejtorise Rajonale Veriore Shkoder. Ky segment rrugor perfshin uren e Milotit (te trenit) dhe perfundon ne nyjen e Milotit (me rrugen e Kombit) është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Lezhes dhe te Milotit , Lacit etj.

Me poshte jane te paraqitur ne forme tabelare segmentet rrugore qe perbejne kete kontrate.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Ura e Matit (e trenit) - Lezhë (deg. Grykë Manati)	10.7	41°41'21.3"	19°42'05.0"	41°46'15.7"	19°39'49.9"
2	Ura e Zogut (MK) - Ura e re Milot (e Trenit)	2.6	41°42'00.6"	19°43'32.5"	41°41'21.3"	19°42'05.1"
3	Rrëshen (Ura e Fanit) - Ura e Zogut (e vjetër)	22.2	41°46'30.7"	19°51'34.2"	41°42'00.2"	19°43'27.8"
4	K/Milot - Ura e Matit (e Trenit) Pllanë	1.1	41°40'56.7"	19°42'36.8"	41°41'21.3"	19°42'05.0"
Shuma (km):		36.6				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 02.04.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore **"Lezhë (D/Grykë Manati)- Ura e Matit (e trenit), Ura e vjeter Milot -Ura e re Milot (E Trenit), Rrëshen (Ura e Fanit) - Ura e Matit (e vjetra), K/Milot -Ura e Matit (e Trenit) "**. Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektivi i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

preventivave për përlogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike të përqendruara më shumë në segmentin “**Ura e Matit(e trenit)-Lezhe (deg.Gryke Manati) (10.7 km)**”. Ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezulton edhe një shtim i konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike. Por duke u nisur nga fakti se se ne disa vende ka amortizim të shtresave rrugore kerkohet nderhyrje per permirsimin e tyre.Po keshtu eshte e nevojshme edhe nderhyrja ne elementet e tjere te rruges. Në segmentin “**Ura e re Milot (Trenit)-Ura e Vjeter Milot” 2.6 km**” ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezulton edhe një mungese e konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike.. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren të rrafshet nuk ka patur problem per mirmbajtje. Ne aksin rrugor “**Ura e Matit(e vjetra)-Rreshen(Ura e Fanit)” 22.2km** gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike të përqendruara më shumë në segmentin “**Ura Matit (e vjetra)-Rubik” me nje gjatesi rreth 12km**”. Gjithashtu evidentohen ndertimi dhe riparimi i disa mureve mbajtjes dhe prites. Ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si tabela apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezulton edhe një shtim i konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike krysisht në segmentin “**Ura Matit (e vjetra)-Rubik” me nje gjatesi rreth 12km..** Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren malor, dhe çdo vit përballet me kushte të vështira atmosferike, vërehet së aksi ka nevoja të metëjshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

- Segmenti rrugor “**Ura e Matit(e trenit)-Lezhe (deg.Gryke Manati) (10.7 km)**,”





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare. Ky segment rrugor ka nevoja të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme. Pothuajse gjatë gjithë segmentit dallohen një numër i madh parapetesh betoni të dëmtuara apo të rrëzuara plotësisht. Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kanaleve anesore të veshura me beton. Po kështu është menduar dhe parashikimi i një sasi vijëzimi sidomos në zonat ku do të nderhyhet me riparim të shtresave asfaltike. Megjithëse rruga është përmirësuar nga ana e sinjalistikës vertikale, përsëri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4 viteve të ardhshme. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve. Një problematikë që vlen të përmendet është dëmtimi i shtresave asfaltike në disa pjesë të segmentit.. Në km 1 është e domosdoshme hapja e një kanali kullues dhe veshja e tij me beton. Po kështu në km 6 është e nevojshme vendosja e 3 tombinove për disiplinimin e ujrave. Njëkohësisht vlen të përmendet se këtu ka nevojë edhe për përmirësim të mëtejshëm të sinjalistikës rrugore. ***U vë re se është e plotësuar pothuajse sinjalistika paralajmëruese në dy krahët e rrugës.*** Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë C për vijëzime është : 2 vijat anësore dhe vija e mesit janë të realizuara me vijë me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Dy vijat anësore janë shumeziar me koeficient 1, ndërsa vija e mesit është shumëzuar me koeficient 0.7. Vijëzimet janë llogaritur nëpër zona të banuara, nëpër shkolla apo institucione dhe nëpër pjesë të rrugës që do të nënshtrohen riveshjeve. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuar në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

● Segmenti rrugor **“Ura e re Milot (Trenit)-Ura e Vjeter Milot” 2.6 km.** është segment i pa plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare.. Në pjesën fundore ka dëmtime të konsiderueshme të shtresave asfaltike të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt. Po kështu është menduar dhe parashikimi i një sasive vijëzimi në km 0 deri në 2.9 si plotësimi me tabela gjate gjithë aksit për 4 vitet e ardhshme. Një problematikë që vlen të përmendet është problem i vendosjeve të mbrojtëseve anësore metalike, vijëzimi i rruges si dhe riparimi i shtresave asfaltike të demtuara. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuar në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

Një problematikë që vlen të përmendet është dëmtimi i në shumë vende të shtresave asfaltike ku është përqendruar kryesisht edhe inspektimi i tyre. Po kështu vëhet re edhe dëmtimi i disa mureve mbajtës, mungesa e sinjalistikës e cila duhet të plotësohet me mirë duke u nisur si nga ajo vertikale dhe horizontale ku me të theksuar është vijëzimi i cili pothuajse mungon duke përjashtuar vendet ku janë bërë riparime apo veshje me shtresa asfaltike. Sic e theksuam më lart me problematike është segmenti I dytë nga Qyteti I Rubikut deri në Rreshen (Ura e Fanit) me një gjatësi rreth 10 km. Gjithashtu ka të dëmtuar edhe mure mbajtës. Për këtë arsye me anë të punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar një rikonstruksion rrënjësor të shtresave asfaltike në disa segmente që sipas mendimit tonë janë me problematike. ***U vë re se është e nevojshme edhe përmirësimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale.***

● Segmenti rrugor **“Ura e Matit (e vjetra) - Rreshen (Ura e Fanit) 22.2 km** është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjendje mesatare, por në shumë vende duhet ndërhyrë për përmirësimin e tyre. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme. Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin e mureve mbajtës të demtuar si dhe vendosje të barrierave metalike anësore. Po kështu sic e theksuam më lart përmirësimin e dukshëm të vijëzimeve pasi mungojnë në pjesën më të madhe të segmentit, por kjo do të realizohet pasi të riparohen shtresat asfaltike. Megjithatë rruga është përmirësuar nga ana e sinjalistikës vertikale, përsëri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4 viteve të ardhshme. Segmenti rrugor **“Ura e Matit (e vjetra) - Rreshen (Ura e Fanit) 22.2 km”** është një segment që shtrihet në një terren mesatar malor dhe me pa mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment nga Projekti i DRV Shkoder rezulton se është ndërhyrë në riparimin e shtresave asfaltike, meqenëse ishin relativisht të demtuara në disa zona por akoma ka nevojë për më shumë. Rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

ndertimit e tyre. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Gjithashtu është menduar dhe ndërhyrja në disa pozicione të favorshme për rrëshqitje, ndërhyrja do të bëhet me anë të zërit “Rrafshim skarpate”. Në kilometrin 5 kemi evidentuar shëmbjen e një muri mbajtes në një gjatësi rreth 12m. Në këtë gjatësi parashikojmë të ndërtojmë një mur Betoni të ri. Eshtë parashikuar të për të rehabilituar një çedim të trupit të rrugës me një gjatësi rreth 60m në km 8. Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime të tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevojën që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve. Në lidhje me tabelat dhe barrierat anesore janë parashikuar në total pasi pothuajse segmenti është i mbuluar. Kjo për arsye se gjatë 4 viteve mund të demtohen. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuar në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasitë e këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet më të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Anë	Përshkrimi i punimit	Njesia	Sasia
--------	----------------------	--------	-------





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

1. PUNIME GERMIMI			
3.119/a	Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3	980
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	150
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	980
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.25m3	m2	80
2. PUNIME SHITESASH			
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	120
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	120
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	120
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	2520
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	12400
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	120
3. ANALIZA TEKNIKE			
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	4400
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	12400
4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE			
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	158
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	10
5. PUNIME HEKUR BETONI 3			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 287	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing 6 ~ 10mm	ton	0.15
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem \varnothing > 12mm	ton	0.2
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3	22
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	120
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	15
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	12
3. 366	Tombino me tuba betoni \varnothing 800, mbi shtrese betoni	ml	24
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	150
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	12
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	5600
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	18
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	44
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	34
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	55
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	25
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	15




REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	110
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	18
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	25
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	22
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	240
3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	12


Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Bashkangjitur janë fotot e realizuara në terren dhe tabelat e shpërndarjes së punimeve rehabilituese periodike:








REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR



GRUPI I PUNËS :

